

TERMAT E REFRENCËS

KONKURS PËR ZGJEDHJEN E SHKRIMTARËVE TË RINJ PËR VALORIZIMIN E TERRITORIT RAHOVECIT PËRMES TREGIMEVE TË SHKURTRA

Data e shpalljes: 30.08.2023

Afati i fundit për aplikim: 10.09.2023

Green Art Center - Prishtina ka kënaqësinë të shpallë të hapur konkursin për shkrimtarët e rinj. Konkursi me temë "Zbulo Rahovecin", organizohet si pjesë e projektit ECOROUTES dhe synon të

inkurajojë dhe frymëzojë shkrimtarët e rinj që të eksplorojnë bukuritë e Rahovecit dhe të ndajnë këndvështrimet e tyre unike me të tjerët. Nëse jeni të apasionuar pas historisë, kulturës, traditave apo monumenteve kulturore e natyrore ky konkurs është një mundësi për të treguar aftësitë tuaja të shkruarit dhe për të promovuar diversitetin e Rahovecit.

Konkursi fton shkrimtarët e rinj nga moshën 18 deri në 33 vjeç, që kanë një lidhje të fortë me Rahovecin, të marrin pjesë në krijimin e tregimeve të shkurtra që nxjerrin në pah veçoritë lokale si territori, trashëgimia kulturore dhe traditat. Tregimet më të mira do të përfshihen në një libër unik që do të përmbajë 20 tregime të shkurtra, të shkruara nga shkrimtarë të rinj nga Shqipëria dhe Kosova. Libri do të botohet dhe shpërndahet në të gjithë zonën e programit.

Konkursi "Zbulo Rahovecin" do të zgjasë deri më 31 maj 2023 dhe u ofron shkrimtarëve të rinj një shans për të përsosur aftësitë e tyre duke marrë pjesë në një projekt krijues.

Projekti "ECOROUTES - Shtigje eko-turizmi në zonën ndërkufitare për promovimin e turizmit alternativ" zbatohet nga Bashkia Kukës dhe Instituti i Kërkimeve Urbane në Shqipëri dhe nga Komuna e Rahovecit dhe Green Art Center - Prishtinë në Kosovë.

ECOROUTES bashkë-financohet nga Bashkimi Evropian dhe Fondet Kombëtare të vendeve pjesëmarrëse, në kuadër të Thirrjes së tretë për Projekt Propozime për Programin e Bashkëpunimit Ndërkufitar IPA Shqipëri – Kosovë 2026-2020.

Inkurajojmë të gjithë shkrimtarët e rinj që të shfrytëzojnë këtë mundësi, të ndjekin rrugën e krijimit dhe të bashkohen me ne për të zbuluar së bashku bukuritë e Rahovecit!

Shënim i rëndësishëm

Ju lutemi sigurohuni që t'i lexoni me kujdes rregullat përpara se të aplikoni në këtë konkurs.



Kush mund të aplikojë?

Të gjithë shkrimtarët e rinj nga mosha 18 deri në 33 vjeç, që kanë një lidhje të fortë me Kukësin dhe janë të apasionuar pas historisë, kulturës, natyrës dhe traditave.

Rregullat dhe udhëzimet për aplikim

- Konkursi është i hapur për krijime origjinale dhe të pabotuara më parë.
- Nuk pranohen tregime që kanë fituar më parë dhe/ose janë përfshira në konkurse të tjera të ngjashme.
- Tregimet duhet të jenë të përshtatshme për një audiencë të përgjithshme.
- Në aplikim lejohet vetëm një (1) tregim për autor.

Si të aplikohet?

Të gjitha aplikimet dorëzohen online në info@greenartcenter.org dhe duhet të përfshijnë:

1. Shtojca 1 – Formulari i Aplikimit i plotësuar.
2. Një biografi e shkurtër e aplikantit, duke përfshirë informacione të tilla si arsimi, përvoja e punës, aftësitë, arritjet si dhe hobi.
3. Fotokopje e një dokumenti të vlefshëm identiteti (Kartë Identiteti ose Pasaportë), e nënshkruar siç duhet.
4. Tregimi i shkurtër lidhur me temën, jo më shumë se 3000 fjalë.

Formati i tregimit

Në fillim të faqes së parë përcaktoni numrin e fjalëve të tregimit të shkurtër. Titulli nuk përfshihet në numërimin e fjalëve.

- Tregimi i shkurtër duhet të ketë emrin e autorit në krye të faqes së parë.
- Tregimi i shkurtër nuk duhet të kalojë 3000 fjalë. Titulli nuk përfshihet në numërimin e fjalëve.
- Faqet duhet të jenë të numëruara dhe numri i faqes duhet të shfaqet në fund të çdo faqeje.
- Titulli i tregimit të shkurtër duhet të shfaqet në kokën e çdo faqeje.
- Skedari i tregimit të shkurtër duhet të ruhet dhe të dorëzohet në këtë format: "Titulli i tregimit – Emri i autorit" (P.sh.: EcoRoutes – Jon Leka).
- Duhet të përdoren fontet standarde si Times New Roman, Arial, Calibri ose Georgia në madhësinë e shkronjave 12 pt, me një distancë të vetme.
- Të gjitha tregimet duhet të dorëzohen në format elektronik, nuk do të pranohet asnjë dorëzim në letër. Formatet e pranueshme janë: .docx ose .pdf.
- Aplikimi duhet të dërgohet në Shqip.

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve

Afati i fundit për dorëzimin e aplikimeve është **10 Shtator 2023**, ora 23:59 (me orën e Kosovës) në mesnatë.

Pas dorëzimit të aplikimit ju do të merrni një email konfirmimi. Ju lutemi kontrolloni postën elektronike në junk pasi emailët mund të përfundojnë atje.

Vlerësimi

TREGIME TË SHKURTRA	PIKËT
Kompetenca gjuhësore dhe teknika e shkrimit	30 pikë
Origjinaliteti i përmbajtjes dhe lidhja me temën e projektit	40 pikë
Aftësia për të përcjellë emocione dhe stili i të shprehurit.	30 pikë
TOTAL	100 pikë

Juria

Vendimi i jurisë është përfundimtar, nuk do të pranohet asnjë korrespondencë individuale përgjatë vlerësimit. Gjykimi është i drejtë dhe i paanshëm.

E drejta e autorit

E drejta e autorit për çdo krijim të dërguar mbetet tek autori, por Instituti i Kërkimeve Urbane ka të drejta të pakufizuara për të botuar tregimet e shkurtra fituese dhe me vlerësimet më të mirë me qëllim përfshirjen e tyre në materialet promovues të prodhuar në kuadër të këtij projekti.

Rezultatet & çmimet

Fituesit dhe shkrimtarët më të vlerësuar do të njoftohen me email më 15 shtator 2023. Për 3 tregimet më të mira është parashikuar një çmim prej **500 euro**.

Për shprendarjen e cmimeve do të njoftoheni përmes e-mail

Për më shumë informacion, mund të kontaktoni: info@greenartcenter.org